Parlamenti Rural mbetet një projekt Evropian...

I promovuar si një model dhe projekt evropian para tri vitesh, Parlamenti Kombëtar Rural në Shqipëri mbetet një projekt me fokus sa mirëqeverisjen po aq dhe demokracinë gjithëpërfshirëse. Puna nga Parlamenti i parë në shtator të vitit 2017 deri në këto ditë përfshin përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme për të krijuar dhe konsoliduar një identitet sa përfaqësues po aq edhe legjitim të Rrjetit Kombëtar për Zhvillimin Rural (ANRD), që do të ndihmonte advokimin për politikë bërje dhe vendimmarrje të mbështetur në evidencë dhe në prioritetet e komuniteteve rurale.

ANRD po zë gjithmonë e më tepër vendin si përfaqësuese e interesave të sektorit privat, shoqërisë civile dhe qeverisjes vendore në sfidat e vendit për zhvillimin e qëndrueshëm rural. Qëndrimet publike të Rrjetit për çështjet e mirëqeverisjes së sektorit kanë qenë shumë të rëndësishme në këtë drejtim. Në tri vitet e fundit, ANRD është shtrirë në të gjithë vendin dhe veprimtaria e saj nuk përfaqëson vetëm 28 organizatat e saj anëtare, por në shumicën e rasteve, Rrjeti është konsultuar në veprimtarinë e vet me deri në 400 vetë që përfaqësojnë si sektorin publik ashtu dhe atë privat.

Mbajtja e këtij forumi kombëtar bën më të dukshme peshën e Rrjetit Kombëtar për Zhvillimin Rural duke operuar në mënyrë gjithëpërfshirëse edhe në kushtet e pandemisë. Është pikërisht anëtarësia aktive e ANRD-së garantuesja e suksesit të këtij Parlamenti duke bërë bashkë virtualisht mbi 500 pjesëmarrës nga çdo bashki e vendit, institucione qendrore, OSHC, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare, anëtarë të Rrjetit Ballkanik dhe të disa Rrjeteve Evropiane për zhvillimin rural.

Gjatë pesë viteve të veprimtarisë së tij Rrjeti ka vendosur raporte të mira bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Autoritetin Menaxhues dhe aktorë të tjerë në të nivel qendror dhe vendor. Nga ana tjetër, pavarësisht përpjekjeve, ANRD ende nuk ka arritur asnjë lloj bashkëpunimi me Komisionin Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Përpjekjet në këto drejtime do të duhet të mbeten objektiv i rëndësishëm i punës sonë në të ardhmen.

Ajo që e dallon Rrjetin Kombëtar për Zhvillimin Rural nga çdo organizëm tjetër është ndërtimi i identitetit të vet në sistemin e qeverisjes së sektorit rural përmes punës për përmirësimin e kapaciteteve të sektorit në të gjithë vendin, ngritjen dhe konsolidimin e instrumenteve të konsultimit publik për çështjet e politikave te zhvillimit rural, monitorimin dhe hartimin e dokumenteve të politikave për një qeverisje më të mirë për zhvillimin bujqësor dhe rural, sensibilizimin edhe advokimin. Si ombrellë organizatash të shoqërisë civile, Rrjeti qëndron fort për promovimin e qasjes “LEADER” në të gjithë vendin.

ANRD mund të kërkojë meritë edhe në dy nisma plotësuese si zhvillimi i dy edicioneve radhazi të aktivitetit “Pro Gruas Rurale” në bashkitë e Tiranës dhe Roskovecit, në përpjekje për ta kthyer këtë aktivitet në traditë të përvitshme. Gjithashtu, inkurajues është dhe ndërtimi i Rural Youth Hub me një program konkret dhe afatgjatë pune që synon të bëj bashkë të rinj dhe të reja të angazhuar në këto drejtime. Puna në këtë aspekt pritet të vazhdojë më tej në të ardhmen.

Në të gjitha drejtimet e punëve, ANRD ka gjetur gjithmonë mbështetje të vërtetë nga drejtuesit e Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe stafi akademik i saj jo vetëm në aktivitete si Parlamenti Rural. Ne shpresojmë shumë në perspektivën e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Me këtë rast, një falënderim i veçantë shkon edhe për drejtuesit e Universitetit Epoka që e mbështetën realizimin e Parlamentit në një format të pazakontë duke ofruar gjithë infrastrukturën dixhitale në ambientet e veta.

Në fund por jo nga rëndësia, këto arritje nuk do të bëheshin të mundura pa mbështetjen e Bashkimit Evropian, që ka qenë financuesi kryesor i ANRD-së në rrugën e vet të zhvillimit dhe konsolidimit. Po ashtu, falenderojmë Bashkëpunimin Gjerman që përmes mbështetjes së GIZ dha kontributin e vet në këtë ngjarje të rëndësishme kombëtare për sektorin.

Ju falenderoj për mbështetjen dhe ju mirëpresim në Parlamentin e dytë Kombëtar Rural.

Sotiraq Hroni
Kryetar i Bordit,
Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural